



Pranuar / Dorezuar Primijsenol/Prodato Received/Delivery	23-05	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Judinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSHCK	4388/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.555/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.555/2023 të datës 24.03.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës ,në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 23.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.555/2023 e datës 24.03.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 003 i datës 24.02.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Shërbimi Korrektues i Kosovës duke u bazuar në dispozitat e nenit 4 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe nenit 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 për gradat e Zyrtarëve Korrektues shpall konkurs të brendshëm me datë 11.10.2022 për pozitën udhëheqës i njëjtit për siguri dhe operativë(pavijon), në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili me datë 24.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 003 i datës 24.02.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitive të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 30.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me datën 06.04.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokoll 2954/2023 të datës 24.03.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër 003 i datës 24.02.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.03.2023 me numër protokoll 3149/2023; Përgjigje në ankesë e datës 06.04.2023 nga organi i punësimit me numër protokoll 3341/2023 bashkë me shkresat e lëndës; Kontratën e punës për kohë të caktuar nga 01.02.2018 deri më datë 31.01.2023 në pozitën Zyrtar Korrektues në Qendrën e paraburgimit në Lipjanë; kopja e konkursit e datës 11.10.2022 me nr.1024; Lista e ngushtë e datës 11.10.2022; Kërkesa për punësim e datës 25.11.2022; Diploma e datës 08.07.2015 me nr.601 e lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Çertifikatë e datës 21.11.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë/dega në Lipjan; Vërtetim i datës 23.11.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Kopja e letërnjoftimit; Vërtetimi i datës 25.11.2022; Referencë pune e datës 25.11.2022; Çertifikatë e datës 23.11.2018; Çertifikatë e datës 12.02.2018; Çertifikatë e datës 27.04.2018; Çertifikatë e datës 09.02.2022; Çertifikatë e datës 29.09.2010; Çertifikatë e datës 01.04.2022; Çertifikatë e datës 14.10.2021; Çertifikatë e datës 04.06.2004; Autorizimi i datës 23.01.2020; Ankesa e datës 15.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Kërkesa për punësim e datës 25.11.2022 për z. ; Kontratë pune për kohë të caktuar e datës 31.01.2023; Diplomë e datës 07.03.2016 me nr.195/16 e lëshuar nga kolegji AAB Prishtinë; Diplomë e shkollës së mesme profesionale Bujqësore në Prishtinë e datës 05.10.1999; Çertifikatë e datës 15.11.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan; Vërtetim i datës 15.11.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 e nënshkruar me datë 23.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 e nënshkruar me datë 12.01.2021; kopja e letërnjoftimit; Vërtetim i datës 16.11.2022; Çertifikatë e datës 11.11.2022; Vendimi i datës 05.12.2022 për themelimin e Komisionit përzgjedhës për procesin e gradimit për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Siguri dhe Operativ në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan (Institucioni Korrektues për Femra); Vendimi i datës 31.01.2023 i Komisionit Përzgjedhës; Vendimi i datës 16.01.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Ankesa e datës 06.01.2023 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vendimi i datës 19.03.2021 për formimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vendimi A.nr.352/2023 i datës 16.03.2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim për rezultatet përfundimtare të datës 01.02.2023; Rezultatet e vlerësimit të testit me shkrim dhe intervistës me gojë nga anëtarët e komisionit vlerësues; Njoftim i rezultatit të vlerësimit për intervistat me gojë i datës 23.12.2022; Njoftim i rezultateve të vlerësimit për testin me shkrim i datës 20.12.2023; Njoftim për rezultatet përfundimtare i datës 23.12.2023; testi me shkrim i datës 16.12.2022 për dhe , Qelës i testit me shkrim, Emaili

sqarues i datës 23.05.2023 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore të institucionit-SHKK dhe Vërtetimin e datës 23.05.2023 mbi përvojën e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Fillimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sipas nenit 4 paragrafit 1 dhe 2, është përcaktuar se: "1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë. 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shitesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve", ndërsa elementet e tjera të marrëdhënies së punës rregullohen me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe konformë këtyre dispozitave ligjore të specifikuara si më lartë përkatësisht nenit 6 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 për gradat e Zyrtarëve Korrektues, Shërbimi Korrektues i Kosovës shpall konkurs të brendshëm me datë 11.10.2022 për pozitën "Udhëheqës i njësisë për siguri dhe operativë(pavijon)".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se kriteret e konkursit të brendshëm për pozitën "Udhëheqës i njësisë për siguri dhe operativë(pavijon)", në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan në Shërbimin Korrektues të Kosovës, i shpallur me datë 11.10.2022 me nr.1024, përveq atyre të përgjithshme që parashihen në ligjin e zyrtarëve publik kanë qenë si në vijim:

- Të ketë nivelin e arsimimit universitar;
- Dy vlerësimet e fundit vjetore të jetë vlerësuar me të paktën mirë;
- Të mos ketë masë disiplinore aktive;
- Përvoja e punës e kërkuar: të ketë së paku 7 vite përvojë pune në graden I (Zyrtar Korrektues) së paku 5 vite përvojë pune në graden II (Mbikëqyrës) apo së paku 3 tri vite përvojë pune në gradën III (Mbikëqyrës i lartë).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se për pozitën "Udhëheqës i njësisë për siguri dhe operativë(pavijon)", në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan në Shërbimin Korrektues të Kosovës kanë aplikuar tre (3) kandidatë, ndërsa njëri është tërhequr në listën e ngushtë janë përfshirë tre (3) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi tutje pas përfundimit të procedurave të konkurrimit i pakënaqur me rezultatin përfundimtar të datës 23.12.2022, me datë 06.01.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës i cili kërkon që të shikohet testi me shkrim me arsyetimin se nuk i janë dhënë pikët e mjaftueshme në testin me shkrim. Komisioni i Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës me vendimin e datës 16.01.2023 ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke obliguar komisionin përzgjedhës të bëjë rishqyrtimin dhe rivlerësimin e testit me shkrim për ankuesin dhe kandidatin përzgjedhës.

Pas rishqyrtimit të testit me shkrim ankuesi ka marrë 75 pikë duke vazhduar në intervistën me gojë ku ka marrë 70 pikë e që në rezultatin përfundimtar ka arritur ti marrë 72.5 pikë, ndërsa kundër kandidati ka arrit ti marrë 76 pikë të kërkuara për pozitën "Udhëheqës i njësisë për siguri dhe operativë(pavijon)", në Qendrën e Paraburgimit (korrektuese për femra)në Lipjan në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Njësia e Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 01.02.2023 ka bërë ripublikimin e rezultatit përfundimtar lidhur me konkursin për pozitën "Udhëheqës i njësisë për siguri dhe operativë(pavijon)", në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan në Shërbimin Korrektues të Kosovës , sipas të cilit kandidati është vlerësuar me gjithsej 76 pikë, ndërsa ankuesi me 74.5 pikë duke u renditur si kandidati i dytë i cili me datë 13.02.2023 ka parashtruar ankesë drejtëpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 16.03.2023 me numër protokollit 2742/2023 ka nxjerrë vendimin A.nr.352/2023 me të cilin hedhet poshtë si e palejuar ankesa e ankuesit duke ju referuar Udhëzimit Administrativ MD-Nr.2/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimin e së Kaluarës së tyre , Periudhën Provuases dhe Promovimin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se ankuesi me datë 15.02.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Shërbimit korrektues të Kosovës me pretendimin ankimor se nuk është i kënaqur me vlerësimin që i është bërë nga Komisioni Përzgjedhës. Komisioni i Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës me vendimin e datës 24.02.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar duke lënë në fuqi listën përfundimtare të Komisionit Përzgjedhës të datës 01.02.2023, pasi që njëjti Komision ka eliminuar të gjeturat e rekomanduara nga Komisioni i Ankesave duke i publikuar rezultatet përfundimtare në faqen zyrtare ku renditet i dyti në listën përfundimtare pas rivlerësimit ka marrë 74.5% pikë, ndërsa kandidati fitues ka arrit ti marrë 76% pikëve mbas rivlerësimit.

I paknaqur me Vendimin me nr.003 të datës 24.02.2023 të komisionit të Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës ,ankuesi me datë 24.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2954/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor se testi im pjesërishtë është rivlerësuar nga Komisioni Përzgjedhës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara sepse e gjithë procedura e konkurimit-përzgjedhjes së kandidatit fitues për pozitën "Udhëheqës i njësisë për siguri dhe operativë(pavijon)",në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan në Shërbimin Korrektues të Kosovës është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimin e së Kaluarës së tyre, Periudhën Provuase dhe Promovimin,poashtu kolegji i këshillit nga shkresat e lëndës ka konstatuar se kandidati fitues z. ka arritur ti merrë 76% të pikëve dhe i cili posedonë dokumentet si në vijim: Diplomën e datës 07.03.2016 me nr.195/16 e lëshuar nga Kolegji AAB në Prishtinë i cili mori titullin Baçelor në Administratë Publike,Kontratën e punës për kohë të caktuar nga 01.02.2018 deri më datë 31.01.2023 në pozitën Zyrtar Korrektues në Qendrën e paraburgimit në Lipjanë, Vërtetimin e datës 23.05.2023 mbi përvojën e punës ku konfirmohet përvoja e punës si zyrtarë korrektues nga data 02.02.2009,dy vlerësimet e fundit të rezultateve në punë për vitin 2020 dhe 2021 me notën e



përgjithshme 3, Vërtetim i datës 16.11.2022 i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë/SHKK, Vërtetimin e datës 15.11.2022 i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme /Policia e Kosovës se i njëjti nuk ka dosje penale dhe Çertifikatën e datës 15.11.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dega në Lipjan, dhe mbi bazë të këtyre elementeve konstatohet fakti se i njëjti i ka plotësuar kriteret ligjore të parapara në konkurs dhe mbi këto elemente përzgjedhja ka qenë në harmoni me legjislacionin përkatës të shërbimit civil përkatësisht Udhëzimin Administrativ MD-Nr.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimin e së Kaluarës së tyre ,Periudhën Provuese dhe Promovimin, rrjedhimisht kolegji i këshillit bazuar në shkresat e lëndës si dhe bazuar në pretendimet ankimore përkundër që ka verifikuar dhe kontrolluar edhe testet me shkrim të ankuesit dhe kandidatit fitues nuk ka mundë të evidentoj ndonjë shkelje përkatësisht ndonjë parregullsi sa i përket vlerësimit dhe mbi këtë bazë konstaton se pretendimi i ankuesit është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në at që u tha si më lartë ka konstatuar se Komisioni i Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës vendimin e datës 24.02.2023 e ka nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin korrektues të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ MD-Nr.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimin e së Kaluarës së tyre ,Periudhën Provuese dhe Promovimin dhe mbi këto arsye ligjore bazuar në arsyetimin si më sipër edhe mbetet në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.555/2023, datë 23/05/2023.

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

